*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

E martë, 28 nëntor 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.48

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjesi, mirë se keni ardhur.

Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës, është çështja me numër KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Vërej se ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave kanë të njëjtën përbërje të ekipit dhe në anën e majtë shoh një ndryshim të vogël.

Keni fjalën, z. Avokat.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse. Mirëmëngjesi. Jemi këtu me z. Shala, me videolidhje si zakonisht. Është me z. Aouini, znj. Juliette Healy, Dzaneta Petravica, Juliette Healy dhe kemi një stazhier të ri, z. Basile Moulera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, mirëmëngjesi, më konfirmoni ju lutem nëse më dëgjoni mirë.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjesi, ju

ndëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë, sot do të dëgjojmë dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes me numër 04280, i cili do të dëshmojë me masa mbrojtëse në sallë dhe nëpërmjet videolidhjes.

Përpara se të fillojmë, Trupi Gjykues dëshiron që të trajtojë një sërë pikash. Por këtë do ta bëjmë në seancë private pas së cilës do të rikthehemi në seancë publike.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Pika e parë ka të bëjë me fletëthirrjen për dëshmitarin e Mbrojtjes numër 1. Deri më sot, dëshmitari nuk është gjendur ende se ku ndodhet dhe fletëthirrja nuk i është dorëzuar ende. Duke qenë se janë bërë të gjitha përpjekjet prej miratimit të fletëthirrjeve, por këto nuk kanë dhënë fryte deri më sot, Trupi Gjykues po mendon që fletëthirrjen ta bëjë publike. Por përpara kësaj, Trupi Gjykues dëshiron të dëgjojë mendimet e palëve të pjesëmarrësve dhe të Zyrës Administrative, pra Mbrojtësit të Viktimave dhe ZPS-së, por sidomos mendimin e Mbrojtjes.

Nuk ka nevojë që këto mendime t’i jepni tani, por do

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

t'jua kërkojmë këtë pas pushimit të drekës. E bëjmë këtë për t'ju dhënë mundësi që të mendoheni për këtë propozim.

Gjithashtu i kërkojmë Avokatit të Mbrojtjes që të paraqesë vërejtjeje të mëtejshme sa i takon fletëthirrjes në bazë të numrit të dëshmitarëve që priten ende të thirren, dhe duke pasur parasysh që dalëngadalë po i afrohet dhe fundi paraqitjes së provave nga Mbrojtja. Po e lëmë mënjanë hë për hë procedurën e zhdëmtimeve dhe kërkesën për ndryshimin e listës së dëshmitarëve.

Krahas kësaj, pra, krahas këtij informacioni, Trupi Gjykues i ka kërkuar një raport Zyrës Administrative sa u takon përpjekjeve që janë bërë pas nxjerrjes së fletëthirrjeve. Këtë raport Zyra Administrative duhet ta dorëzojë deri ditën e martë 12 dhjetor 2023 [Sipas përkthimit] nëse nuk do të dorëzohet fletëthirrja deri atëherë, sepse po vijohet të punohet për këtë.

Pra, për këtë do flasim pas pushimit të drekës.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Sot do të zhvillojmë tri seanca nga një orë e gjysmë secila, me pushimet si zakonisht.

Znj. Sekretare, ju lutem kërkoni që dëshmitari të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit përmes videolidhjes dhe të prezantoni të gjithë të tjerët që janë në sallë, krahas dëshmitarit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes videolidhjes]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për procesverbalin këtu në mjediset ku ndodhet dëshmitari, është dëshmitari me numër 04280 dhe Sekretari i Gjykatës. Faleminderit të nderuar Gjykatës.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Z. Dëshmitar, mirëmëngjesi dhe mirë se keni ardhur në Dhomat e Specializuara. Më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po. *Yes.* Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. dëshmitar, si jeni sot?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Që në mëngjes edhe tash po e ndij, nuk jam mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të përpiqemi sa më shumë, z. Dëshmitar, që ta mbajmë parasysh këtë gjë sot gjatë dëshmisë që do jepni këtu.

Z. Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Përpara se të fillojmë kam disa gjëra për t'jua thënë.

Së pari, z. Dëshmitar, dua t'jua shpjegoj shkurtimisht masat mbrojtëse që janë miratuar për dëshminë tuaj këtu.

Z. Dëshmitar, ju është caktuar një pseudonim. Kjo do të thotë se emrin e vërtetë nuk do t'jua cekim asnjëherë, por do t'ju quajmë gjithmonë "Z. Dëshmitar", me këto fjalë pra, në mënyrë që publiku mos t'jua mësojë emrin. Po kështu, dëshmia juaj do të jetë me ndryshim të fytyrës dhe ndryshim të zërit. Kjo do të thotë që askush që e ndjek dëshminë tuaj jashtë kësaj salle, nuk mund t'jua shikojë fytyrën dhe nuk mund t'jua dëgjojë zërin e vërtetë gjatë dëshmisë tuaj.

Kur t'ju bëjmë pyetje përgjigjet e të cilave nuk jua

zbulojnë identitetin, këtë do ta bëjmë në seancë të hapur. Që do të thotë se publiku mund të dëgjojë se çfarë thuhet këtu në sallën e gjyqit. Por kur t'ju bëhen pyetje, kur t'ju kërkohet që të përshkruani diçka e cila lidhet drejtpërdrejt, pra, në mënyrë specifike, me ju, apo që kur ju kërkohet të përmendni fakte për shkak të të cilave mund të zbulohet identiteti juaj, këtë gjë mund ta bëjmë në seancë private. Dhe kjo do të thotë se, në këtë rast, nuk do të ketë transmetim dhe askush tjetër jashtë kësaj salle gjyqi nuk mund të dëgjojë se çfarë thuhet këtu në sallë.

Nëse gjatë seancës së hapur qëllon të thuhet ndonjë gjë që mund ta identifikojë, mund t'ju identifikojë juve, atëherë këtë informacion do ta mbrojmë, do ta heqim nga transmetimi, sepse dëshmia juaj do të transmetohet me vonesë, kështu që ne mund të heqim çdo informacion nga transmetimi që mund të shikohet apo dëgjohet nga publiku.

Masat mbrojtëse të cilat sapo jua shpjegova, z. Dëshmitar, a janë të qarta, a i keni të qarta?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Z. Shala, për procesverbalin, a e dëgjoni mirë përkthimin, apo dhe zërin e dëshmitarit?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

Faleminderit, e mbajtëm shënim.

Z. Dëshmitar, ju kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës, për ta ndihmuar këtë Trup Gjykues që të marrë një vendim.

Në fillim do të bëni betimin solemn për të thënë të vërtetën. Pas të cilës do t'ju bëjnë pyetje, fillimisht Avokatët e Mbrojtjes të z. Shala, pastaj përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, pastaj përfaqësuesit e Viktimave që marrin pjesë në këtë çështje gjyqësore dhe në fund fare ne, anëtarët e Trupit Gjykues.

Përpara se të bëni betimin për të thënë të vërtetën, dëshiroj t'ju jap disa udhëzime dhe disa këshilla praktike se si t'u përgjigjeni pyetjeve që do t'jua bëjmë.

Z. Dëshmitar, dëgjojeni me kujdes secilën pyetje. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund të kërkoni që t'jua përsëritim. Duam të na thoni të vërtetën, duam të na tregoni se çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar vetë ju. Nëse nuk e keni parë vetë apo nëse nuk e keni dëgjuar vetë, por e keni marrë vesh me ndonjë mënyrë tjetër, atëherë na e thoni këtë dhe na e shpjegoni.

Mund mos t'ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve, nuk ka problem për këtë. Ju lutem, jepni dëshmi vetëm për atë që ju kujtohet, për atë që mbani mend. Mos sajoni gjëra, mos i merrni me mend gjërat. Nuk ka asgjë të keqe të thoni që "Nuk e

di, apo "Nuk e mbaj mend", "Nuk më kujtohet".

Ju lutem, përgjigjuni vetëm pyetjeve që do t'jua bëjmë, se po të kemi nevojë për më shumë sqarime do t'jua kërkojmë dhe ato. Ju rikujtoj gjithashtu se keni të drejtën të mos pranoni të jepni dëshmi për gjëra të cilat mund t'ju fajësojnë në përputhje me rregullën 151(1) të Rregullores.

Z. Dëshmitar, a i keni kuptuar të gjitha këto deri tani?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, i kam kuptuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

I kam tani edhe disa këshilla praktike. Ju lutem, mbani parasysh sa vijon.

Të gjitha gjërat që ne i themi këtu, gjithçka që themi përkthehet dhe regjistrohet. Prandaj dhe është shumë e rëndësishme që të flisni afër mikrofonit që e keni përpara, që të flisni ngadalë dhe që të flisni qartë. Duhet të filloni të flisni, z. Dëshmitar, pra duhet të filloni të flisni vetëm pasi personi që po jua bën pyetjen e ka mbaruar pyetjen. Madje, është mirë të prisni nja pesë sekonda, pra numëroni deri në pesë me vete, si të thuash, dhe vetëm atëherë duhet të filloni ta jepni përgjigjen. Sepse kjo mundëson që të përkthehet e të regjistrohet gjithçka.

Nëse unë ngre dorën, z. Dëshmitar, kështu, nëse do ta ngre dorën kështu, ju lutem mos flisni më. Do t'jua ndërpres fjalën duke ngritur dorën sepse nuk dua të flas vetë, që të

mos flasin dy veta njëkohësisht. Ndonjëherë mund ta ndërpresim videolidhjen nga salla e gjyqit këtu sepse mund të kemi nevojë që të diskutojmë diçka të cilën nuk duhet ta dëgjoni ju.

Në fund, nëse keni ndonjë pyetje, nëse keni nevojë për pushim, apo nëse keni nevojë për diçka mjafton të ngrini dorën dhe unë do t'jua jap fjalën dhe ju mund të flisni pastaj.

I kuptuat të gjitha këto, z. Dëshmitar?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, i kuptova.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Dëshmitar, atëherë si me çdo dëshmitar tjetër, do t'ju kërkoj tani të bëni betimin solemn për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se përbën vepër penale në juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhënia e dëshmisë së rrejshme. E kuptoni këtë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, e kuptoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. Sekretar, ju lutem jepini dëshmitarit tekstin e betimit solemn.

Z. Dëshmitar, ju lutem lexoni tekstin që jua kanë vendosur përpara.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të

vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04280

[Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Jeni tani nën betim për të thënë të vërtetën.

Në fund, z. Dëshmitar, dëshiroj t'ju shpjegoj përse ju kemi thirrur të dëshmoni përpara Dhomat e Specializuara.

Është, arsyeja është se me kërkesë të Mbrojtjes së z. Shala, i akuzuari në këtë çështje gjyqësore, që ju jeni thirrur të dëshmoni pasi vetë Mbrojtja nuk arriti që t'ju thërriste si dëshmitar. Avokatët e Mbrojtjes kanë menduar se jeni me rëndësi për çështjen e z. Shala.

Trupi Gjykues e ka miratuar kërkesën e Mbrojtjes sepse ekziston mundësia që mund të keni ndonjë informacion për ndonjë krim për kryes të pretenduar të ndonjë krimi, apo për rrethana të rëndësishme që kanë lidhje me procesin penal në këtë çështje gjyqësore.

Këtë mundësi mund ta vlerësojë vetëm Trupi Gjykues. Ju si dëshmitar, keni detyrimin që të paraqiteni dhe t'u përgjigjeni pyetjeve.

Shpresoj që të jetë e qartë kjo.

Do të fillojmë tani --

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të fillojmë tani me dëshminë tuaj, z. Dëshmitar. Do të fillojmë me pyetjet që do t'ju bëjë Avokati i Mbrojtjes.

Z. Avokat, keni tri orë në dispozicion për t'i bërë pyetje këtij dëshmitari. Si gjithmonë, mund ta informoni Trupin Gjykues për ndryshime të këtij planifikimi.

Keni fjalën, ju lutem mbani parasysh nevojën për të kaluar apo jo në seancë private. Përpara se t'ju jap fjalën juve, shikoj që ka ngritur dorën dëshmitari, kështu që do t'i jap një herë fjalën dëshmitarit pastaj juve.

Z. Dëshmitar, vura re që keni ngritur dorën.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni fjalën.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Znj. Gjyqtare, unë kam një kërkesë, brenda mundësive. Për shkak të, se gjendja ime shëndetësore veç po shifet, keni parasysh deklaratën time --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, një moment ju lutem --

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] -- të fundit që e kam dhanë --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të kalojmë në seancë private për këtë.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, dua t'ju informoj ashtu siç ju tregova edhe në seancë private, dhe kjo shërben edhe për të informuar publikun, që ne dëshminë tuaj sot do ta vazhdojmë në pjesën dërrmuese të saj në seancë private. Kjo është thjesht për t'i bërë të ditur palëve se si do të procedojmë sot. Në rregull.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni përsëri në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, tani do ta bëjmë një pushim prej 30 minutash, deri në orën 10.35 [Sipas përkthimit]. Shpresoj që të mundeni të pushoni sadopak e të vazhdojmë pastaj me pyetjet e Avokatit.

Z. Asistent, ju lutemi shoqërojeni dëshmitarin që të dalë prej andej.

Faleminderit, z. Dëshmitar.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari ka dalë nga dhoma këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Asistent.

Do të bëjmë tani ndërprerjen e seancës për 30 minuta.

--- Pauza fillon në orën 11.05

--- Seanca rifillon në orën 11.36

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët. Për procesverbal shikoj që ZPS-ja ka të njëjtën përbërje.

Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Jam vetëm unë, nuk ka njeri tjetër nga ekipi im.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. E mbajtëm shënim për procesverbal.

Po Mbrojtja?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe ne jemi me të njëjtën përbërje si më herët sot.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala a na dëgjoni?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Vazhdojmë tani. Do t'i kërkoj Asistentit që të sjellë dëshmitarin në vendin ku ai gjendet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për procesverbal për të konfirmuar që në mjedisin në distancë të pranishëm janë Dëshmitari 04280 dhe unë, Asistenti i Gjykatës.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Asistent i Gjykatës. Faleminderit që na konfirmuar praninë tuaj, së bashku me dëshmitarin në mjedisin në distancë.

Mirë se erdhët përsëri, Dëshmitar. A më dëgjoni mirë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Shala, a e dëgjuat përgjigjen e dëshmitarit?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po e dëgjova shumë mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Tani do ju jap përsëri fjalën ju, Avokat. Dëshironi që të kalojmë në seancë private apo dëshironi që të kalojmë në seancë publike, Dëshmitar -- z. Aouini?

Z. AOUINI: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Përpara se sa ta bëjmë këtë gjë, z. Shala a e fik dot mikrofonin?

Nuk ju dëgjova z. Shala. Më dëgjuat? Ju kërkova që të fiknit mikrofonit.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mikrofoni i fikun është te unë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare e seancës, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A ju kujtohet që ka ndodhë një varrim, një funeral, domethënë, në mjediset gjatë kohës që ju ishit aty?

PË. Jo, s'është e vërtetë.

PY. Pak a shumë a ju kujtohet si ishte e organizuar -- si ishin të organizume këto mjedise?

PË. Jo, unë nuk kam pasë qasje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund t'i përgjigjeni pyetjes ose mbase nuk është përkthyer mirë.

Z. Avokat, ju lutem, bëjeni mirë pyetjen -- bëjeni edhe një herë pyetjen, më falni, sepse ishte shumë larg përgjigja nga pyetja.

Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, unë propozoj që të tregojmë fotografi në ekran dhe të shohim nëse mund të identifikohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

sigurisht mund të ecni, po unë u habita dëshiroj që ta bëni pyetjen prapë nga e para sepse dua të sigurohem a kishte probleme në përkthim a si.

Z. AOUINI: [Përkthim] Shumë mirë.

PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet pak a shumë çfarë lloj godinash a ndërtesash kishte aty tek këto mjediset që ju i quajtët kazermë. Ju përmendët edhe magazinën, po a ju kujtohet se çfarë godinash kishte aty dhe si ishin këto godina?

PY. Nuk më kujtohet se ka kaluar një kohë mjaft e gjatë mbi 20 e ca vitesh. Veç e di që kanë qenë godina të vjetra.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, ky është momenti i duhur për të paraqitur ndonjë material që doni t'ja tregoni dëshmitarit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Do të fillojmë pra, do të tregojmë faqe të ndryshme të të njëjtit dokument me numër ERN-je, me numër SPOE40010264-40010559. Mund ta fillojmë me faqen numër 3.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, znj. Sekretare, mund t'i paraqitni.

Z. Avokat, pasi ta mbyllni këtë pjesë, kam edhe unë një pyetje për sqarim, por të mbarojmë me këtë njëherë.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. A e shihni fotografinë që keni përpara z. Dëshmitar?

PË. Po, e shoh.

PY. A njihni diçka nga kjo fotografi?

PË. Jo, nuk njoh kurrgjë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë, ju lutem, në faqen 15.

PY. Po këtë fotografi a e njihni, apo diçka që paraqitet aty në fotografi, a e njihni?

PË. Jo, nuk më kujtohet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faqen 14, ju lutem.

PY. E njëjta pyetje, z. Dëshmitar, a njihni diçka nga kjo fotografi?

PË. Jo, nuk e njoh.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faqe 11, ju lutem.

PY. Po në këtë fotografi a njihni diçka?

PË. Nuk më kujtohet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faqja 19, ju lutem.

PY. Z. Dëshmitar, po këtë a e njihni, a diçka në këtë fotografi, a ju kujtohet diçka?

PË. Jo, asgjë nuk më kujtohet.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, unë me këto fotografi mbarova. Nuk e di nëse është momenti që ju të bëni pyetjet tuaja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Avokat, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

PY. Z. Dëshmitar, tani jeni në seancë publike. Ju lutem, bëni kujdes të mos thoni asgjë prej së cilës mund t'ju identifikojnë.

Kam këtë pyetje: Z. Dëshmitar, në vitin 1999, gjatë asaj periudhës të cilën sapo e cekëm, sapo e folëm, gjatë luftës, a dinit, a e njihnit apo a keni dëgjuar për një person të quajtur Pjetër Shala?

PË. Jo, nuk kam -- nuk e kam parë dhe nuk kam dëgjuar për të, përveç tash kur ka fillue seanca gjyqësore.

PY. Z. Dëshmitar, gjatë të njëjtës periudhë në vitin 1999 gjatë luftës a e keni njohur apo a e keni dëgjuar për dikënd të cilin me nofkë e thërritshin Ujku?

PË. Jo, nuk kam dëgjuar.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nëse ju nuk keni pyetje të tjera lidhur me këtë temë mund të rikthehemi në seancë private për pyetje të tjera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. Znj. Sekretare, ju lutem, na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj do të donim që të tregonim disa fotografi për hir të

identifikimit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, mundet.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, do t'ju tregojmë disa fotografi dhe do t'ju pyesim nëse i njihni personat në fotografi apo jo.

Z. AOUINI: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të fillojmë me numrin SITF000372465-00372466, faqen 2.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të veproni, znj. Sekretare.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, e njihni këtë person?

PË. Jo.

PY. Faleminderit.

PY. Se ka kaluar një kohë e gjatë edhe nuk di kush mundet të jetë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Duam që të tregojmë një fotografi tjetër dhe është fotografia që sapo e kemi nxjerrë si material me numër DPS01729 që është versioni i redaktuar i faqes 10 të dokument numër ERN 059113-059144. Të dyja ERN-të do t'i jap për procesverbalin më mbrapa.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare tashmë e paske paraqitur në ekran.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. A e njihni këtë person, z. Dëshmitar?
PË. Jo, nuk po e njof.
PY. Faleminderit.
Z. AOUINI: [Përkthim] Do të kalojmë tek një tjetër fotografi, SITF00372523-00372525 RED, faqja 2.
PY. Z. Dëshmitar, a e njihni personin në këtë fotografi?
PË. Jo, nuk po e njoh.
Z. AOUINI: [Përkthim] Do të kërkoj që të paraqitet një tjetër fotografi. Për procesverbal është dokumenti 0077978 deri në 077982, në faqen 1.
PY. Z. Dëshmitar, a e njihni ndonjë person në këtë fotografi?
PË. Jo, nuk po e njoh.
Z. AOUINI: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të paraqiste në ekran dokumentin SITF00374418 deri në 00374419 në faqen 2.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem vazhdoni.
Z. AOUINI: [Përkthim]
PY. A e njihni këtë person, z. Dëshmitar?
PË. Jo, nuk po e njoh.
Z. AOUINI: [Përkthim] Tani le të paraqesim fotografinë e fundit. Për Sekretaren është dokumenti SITF00372523 deri në 00372525 RED në faqen 3.
PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë person?
PË. Jo, nuk po e njoh.

PY. Shumë faleminderit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Mund t'i heqim të gjitha fotografitë nga ekrani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Do të kalojmë në një temë paksa të ndryshme. Pyetja që kam për ju, z. Dëshmitar është si më poshtë, gjatë kohës kur keni qëndruar në kazerma, a keni parë ndonjë person të ndaluar aty?

PË. Jo, nuk kam parë.

PY. Burra, gra, civilë, ushtarë, ndokënd që me ç’kuptove ti ishte i ndaluar ose i arrestuar aty në një formë ose në një tjetër, keni parë?

PË. Jo, jo nuk kam parë.

PY. A e dinit, apo a e keni kuptuar më pas që gjatë periudhës që ju keni qenë aty në kazerma që ka pasur një godinë që përdorej për ndalimin ose arrestimin e njerëzve?

PË. Nuk e di unë që ka patur.

PY. A keni parë apo a keni dëgjuar që dikush të jetë marrë në pyetje apo të jetë intervistuar për dyshime, për kryerje krimesh ose për shkaqe të tjera atje?

PË. Jo, nuk kam dëgjuar.

PY. A keni parë ndonjë civil brenda kazermave që kryenin ndonjë formë, ndonjë trajtë pune, ndonjë punë të caktuar?

PË. Jo, nuk kam parë.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. Z. Dëshmitar, gjatë kohës kur keni qëndruar në kazerma, a keni dëgjuar, keni njohur apo keni parë ose keni parë ose keni dëgjuar rreth -- nga një person tjetër që ka kaluar rrugës aty dhe që ka vdekur?

PË. Jo, nuk e di, nuk kam dëgjuar.

PY. A e keni mësuar ndonjëherë ose a e keni dëgjuar në çfarëdolloj kohe, domethënë edhe pas lufte, a ka ndodhur që të keni dëgjuar informacion për njerëz që janë arrestuar në kazermë ose janë ndaluar në kazermë në një pikë të caktuar kohe?

PË. Jo, nuk kam dëgjuar.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushime dreke deri në orën 2.30. Shpresoj që të keni mundësi që të pushoni sado pak gjatë këtij pushimi. Faleminderit për përpjekjet e konsiderueshme gjatë seancës së paradites. I vlerësojmë shumë përpjekjet tuaja. Tani do t'i kërkoj Asistentit të Gjykatës që t'ju nxjerrë nga ambienti ku jeni. Faleminderit edhe një herë Dëshmitar.

[Dëshmitari largohet përmes videolidhjes]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari është larguar nga ambienti.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Asistent.

Avokat e shoh që jeni ngritur në këmbë. E keni fjalën për të thënë çfarëdolloj gjëje që doni të thoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ne duam që të japim disa referenca duke u treguar të kujdesshëm. Ne do të trajtojmë disa

pretendime të cilat rrjedhin nga disa dokumente që nuk janë pjesë e materialeve tona. Ne nuk do t'i përdorim ato. Megjithatë, në mënyrë të tillë që të gjitha palët ta dinë se nga ku e kanë origjinën e pyetjet e mia dëshiroj që t'i jap këto numra referencash për palët sepse siç thashë këto nuk janë materiale në listën e prezantimeve ose të materialeve tona.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po me sa e kuptoj unë, përderisa do i përdorni si bazë për pyetjet tuaja duhet të ishin si pjesë e listës së materialeve tuaja. Këtë po thoni? Apo po bëj unë interpretim jo të saktë?

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është edhe e vërtetë, po jo tërësisht e vërtetë. Se ne do të pyesim lidhur me disa emra. Nuk është se do i përdorim dokumentet. Por, për të gjitha palët për ta kuptuar se cila është baza e pyetjeve tona, ose nga ku i kemi marrë këto emra, ne sugjerojmë që t'i japim këto numra referencash për dokumentet se do pyesim dëshmitarin në qoftë se e njeh një person të caktuar apo jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të thoja që si rregull i përgjithshëm, në qoftë se pyetjet mbështesin informacione të caktuara, atëherë materialet ose informacionet e caktuara duhet të jenë pjesë e materialeve tuaja. Pjesë e materialeve që ngarkoni në sistem. Dhe mendoj që materialet që ju po i referoheni do të ishte mirë që të ishin ngarkuar në materialet e Mbrojtjes.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

Megjithatë dua t'i jap fjalën tani Prokurorit edhe Mbrojtësit të Viktimave. Unë personalisht me thënë të drejtën nuk shikoj ndonjë problem që t'i përdorësh ato, por është thjeshtë për çështje përgatitjeje sepse të gjitha dokumentet që ju ngarkoni në sistemin tuaj ne i lexojmë, i ndjekim, i shqyrtojmë dhe kjo na ndihmon tepër që të ndjekim më me profesionalizëm procesin gjyqësor.

Prokuror, keni ndonjë gjë për të shtuar?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi gjë për të shtuar as ne.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A doni që t'i jepni numrat ERN tani?

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, parapëlqejmë që ta bëjmë këtë me postë elektronike në fakt. Do të ishte më mirë që t’ja u nisnim ashtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, mua më pëlqen më tepër ky si opsion. Kështu që do të ishte mirë që të vazhdoni kështu të na dërgonit një mesazh elektronik t'i kemi në një dokument. Edhe për të ardhmen kjo mund të jetë një zgjidhje e përshtatshme. Mund të shtoni gjithashtu edhe referencat që është pjesë e transkriptit të përkohshëm. Ja të gjej faqen e transkriptit të përkohshëm. Nuk e mbaj mend përmendësh në fakt për momentin. Gjithsesi do ta

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

lë me kaq. Nuk dua të futem në më tepër hollësi. Besoj që isha e qartë në atë çfarë thatë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, mbase kishte një keqkuptim sepse kemi një rregull që -- mirë e lëmë me kaq. Në rregull, e nderuar Gjykatëse, do vendosim mesazhin me postë elektronike çdo gjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Po presim mesazhin përmes postës elektronike atëherë.

Atëherë, sa i takon përkthyesve ka diçka tjetër që dua të diskutoj me palët që do të trajtohet për dy minuta. Ju kërkoj ndjekë përkthyesve edhe një herë.

Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Do të bëjmë tani pushimin prej një ore e gjysmë.

Këtu ndërpritet seanca.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.09

--- Seanca rifillon në orën 14.43

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

se jeni rikthyer.

Z. Shala, mirë se jeni rikthyer dhe ju. Më dëgjoni mirë?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Fillimisht të shikojmë praninë e ekipeve. ZPS-ja me të njëjtën përbërje. Shoh që është edhe Mbrojtësi i Viktimave.

Për Zyrën Administrative, ju lutem prezantohuni. Keni fjalën.

ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Më quajnë Ralph Roche, përfaqësoj Zyrën Administrative sot.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokati Mbrojtës, keni të njëjtën përbërje?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Thuajse. Z. Mulera nuk është më me ne dhe znj. Kailin është këtu me ne.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Faleminderit.

Përpara se të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit, dëshiroj që të kalojmë në seancë private.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F793*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Avokat, do t'jua jepja juve fjalën të parëve në këtë moment sa i takon pyetjes së Trupit Gjykues për publikimin e fletëthirrjeve, por në fillim do t'ia jap fjalën Zyrës Administrative.

Z. Roche, keni fjalën.

Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit. Vetëm këto minutat e fundit kemi marrë një përditësim operativ nga *[REDAKTUAR]* e Zyrës Administrative, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* se ia kanë dalë mbanë që të gjejnë dëshmitarin DW-401 dje pas dreke. Deshën t'ia dorëzonin fletëthirrjen, po ai refuzoi ta pranonte dhe ka nënshkruar dokumentin ku bën të ditur se ka refuzuar të pranojë fletëthirrjen. Sapo kemi marrë kopje të dokumenteve përkatëse të cilat do t'ia dorëzojë Trupit Gjykues me të mu dhënë rasti.

Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Atëherë, hë për hë, nëse palët dhe Mbrojtësi i Viktimave dëshirojnë të komentojnë, do të thosha që do ta ndjekim në vijimësi dhe do të mbetemi në kontakt përmes postës elektronike apo përmes parashtrimeve të protokolluara. Por nëse ndonjë prej palëve apo Mbrojtësi i Viktimave dëshiron që të marrë fjalën, mundet sigurisht. Jo? Mirë. Në rregull.

Shumë mirë. Faleminderit. Atëherë ky është një tjetër

zhvillim. Faleminderit shumë, z. Roche. Do të vijojmë tani me një temë tjetër. Ju mund të dilni nga salla e gjyqit. Faleminderit shumë.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni sërish në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi sërish në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Tani sa i takon kërkesës së Mbrojtjes për të ndryshuar listën e materialeve për t'u përdorur me dëshmitarin që është çuar me email dhjetë minuta pasi kishte kaluar ora 2.30.

Z. Prokuror, keni ndonjë kundërshtim?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sa i takon dokumenteve, këto dokumente janë edhe në listën tonë, nuk kemi kundërshtim. Por ka një dokument tjetër që është SITF0009727-9751, që nuk është e qartë për ne pse Mbrojtja ka thënë që do që ta fusë këtë dokument në këtë listë.

Ka një individ që ka të njëjtin emër me dëshmitarin që kemi këtu sot, po s'është i njëjti person në fakt. Kështu që nuk jemi të qartë pse është shtuar ky dokument në këtë listë materialesh. Për këtë, po, kemi kundërshtim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për këtë do të kalojmë në seancë private. Mbrojtësi i Viktimave,

qëndrimi juaj cili është?

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni sërish në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi rikthyer në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Shumë mirë. Kërkesa juaj miratohet. Dhe për të ardhmen duam që në listën e prezantimit të materialeve që do të përdorni duam që të përfshijë çdo gjë, përfshirë edhe

transkriptin e dëshmive me qëllim njoftimi.

Ka edhe një gjë tjetër të cilën dua t'ia komunikoj palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave sa i takon dëshmitarit.

Kemi verifikuar me ZMMD-në gjatë pushimit sesi është dëshmitari dhe kemi marrë dijeni se vazhdon të jetë në gjendje që të vijojë dëshminë.

Në rregull. Do të bëjmë rilidhjen përmes videolidhjes me dëshmitarin. Po e shikoj që lidhjen e kemi. Mund të vazhdojmë.

Z. Asistent, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin që të hyjë në dhomë.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju konfirmojmë se ndodhemi këtu me Dëshmitarin W04280 dhe unë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mirë se u rikthyet, z. Dëshmitar. Më dëgjoni mirë?

Nuk jua dëgjova përgjigjen.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani e dëgjova. Faleminderit.

Z. Shala, e dëgjuat zërin e dëshmitarit?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjova fort mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

rregull.

Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën të vijoni me pyetjet dhe sikur thatë që edhe nja dhjetë minuta ju duheshin për pyetjet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, faleminderit, e nderuar Gjykatëse. Mbase dhe më pak.

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.
PË. Mirëdita.
PY. Do të bëjmë tani pyetjet e fundit që kemi ne si ekip për ju sot. Pyetjet e mia kanë të bëjnë pas luftës, pasi u kthyet në vendin tuaj.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase duhet të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

Znj. Sekretare, ju lutem na riktheni në seancë private.

[Seancë private][Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Avokat, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

PY. Z. Dëshmitar, pas lufte, pasi jeni kthyer në Kosovë dhe gjatë muajve e viteve gjer më sot, a keni parë ndokënd, a keni

parë prapë ata persona që i keni parë në kazermë? Në kazermën e Kukësit e kam fjalën.

PË. Jo. Nuk kam pasë kontakt fare me askënd.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. Jo, pyetja është paksa ndryshe. Nëse në ndonjë moment të caktuar pas lufte mos ia keni thënë një gjë të tillë dikujt, pra, jo se ka ndodhur vërtetë ashtu, po a i keni tregu dikujt që ka qenë kështu?

PË. Jo, s'kam bisedu me askënd.

PY. Faleminderit shumë, z. Dëshmitar. Qëllimi i këtyre pyetjeve ishte me verifiku informacione, jo me ju bezdis *[REDAKTUAR]*. Ju falënderojmë shumë për përpjekjet tuaja.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne këto pyetje

kishim si fillim.

PY. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, pyetjet e Avokatit Mbrojtës mbaruan këtu. Tani do t'ia japim fjalën Zyrës së Prokurorit të Specializuar për t'ju bërë dhe ata pyetje. E kuptoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po. Në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Prokuror, keni fjalën. Dhe nëse keni nevojë të kalojmë në seancë private, informojeni Trupi Gjykues për këtë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse. Po, na duhet të kalojmë në seancë private që prej fillimit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

A ju kujtohet, se kur u regjistruat pasi mbërritët në bazën e UÇK-së në qoftë se ju pyetën se çfarë profesioni kishit në atë kohë? A ju kujtohet t'ju kenë pyetur për profesionin kur shkuat në bazën e UÇK-së? Domethënë, a ju pyetën si e keni emrin, si e keni mbiemrin dhe çfarë pune bëni? Ja u bënë këtë pyetje se çfarë profesioni keni ose pune bëni?

PË. Nuk më kujtohet për profesionin. Po e di që më pyetën për vjetët sa vjeçar jam dhe për anëtarë të familjes, sa anëtarë i familjes i kam dhe a kam dikënd që e la aty si përgjegjës.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. A vutë re nëse në oborrin e kësaj baze kishte, ishte ngrit ndonjë çadër fshatare ku mundet njerëzit me bë dush?

PË. Nuk e kam pa.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vura re që u ngrit në këmbë Avokati i Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, mbase s'është shumë problem i madh, po hera e parë që po e përmendin fjalën oborr. Mbase duhet të sqarohemi a e kupton, a ke qenë në dijeni të dëshmitarit të një oborri apo jo që ta sqarojmë si fakt. Që të mos jemi të paqartë pastaj nga përgjigja e vetë dëshmitarit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

Vërej që pohon me kokë z. Prokuror, pra, që e pranon.

Përfitoj nga rasti që t'ju kërkoj që ta mbyllni sot

pjesën tuaj të pyetjeve në orën 4.00 pa pesë sepse dëshiroj që të bëj dhe unë një pyetje për këtë temë dhe dua që ta mbyllim në orën 4.00 sot seancën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po a mund të vazhdoj nesër?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po patjetër që po. Dhe ju kërkoj ndjesë që nuk isha e qartë. Nuk e kisha ndërmend, patjetër. Po për sot e kisha fjalën që keni dhe pesë minuta kohë në mënyrë që të mbyllim dhe ca çështje të tjera procedurale pastaj.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, e nderuar Gjykatëse.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më pas dëshiroja që të bisedoja me dëshmitarin një skicë që kam, po kjo mund të zgjasë më shumë se pesë minuta, kështu që nëse do donit që ju të – nëse doni që të mbarojmë pas pesë minutash më mirë ta mbaroj tani, ta mbyll tani dhe të rivazhdojmë nesër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Kjo përputhet shumë mirë dhe me orarin tonë.

Atëherë, znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, ne do ta ndërpresim seancën e sotme pas pak minutash. Kështu që për sot, pyetjet për ju i kemi mbaruar sot. Do të vazhdojmë nesër. Z. Prokuror, do të vazhdojë nesër me pyetjet që i ka për ju.

Do të pyes Mbrojtësin e Viktimave, ju parashikoni pyetje për dëshmitarin?

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk besoj se do kemi pyetje. Nuk mendoj se do kemi pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

Nuk e di nëse Mbrojtja mund të na thotë që tani që të ketë një raund të dytë pyetjesh apo jo, apo është shumë herët. Që ta dijë dëshmitari, po nëse ju s'keni përgjigje, s'ka problem.

Z. AOUINI: [Përkthim] Gjer më tani shumë të kufizuara mund t'i kemi pyetjet e tjera. Po do shohim nesër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Nesër paradite parashikoj që do të bëjmë prapë seancë, z. Dëshmitar. Kështu që do jemi bashkë prapë nesër paradite. Ju falënderoj shumë për përpjekjet tuaja të sotme për dëshminë. Ju uroj të pushoni sot mbas dreke dhe do të rishihemi bashkë nesër në orën 9.30.

Ju lutem mos diskutoni për dëshminë tuaj me askënd. Faleminderit. Z. Asistent aty do t'ju ndihmojë që të dilni nga dhoma.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, dëshmitari ka dalë nga sallë e gjyqit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, shumë z. Asistent. Për sot tani mund ta bëjmë ndërprerjen e videolidhjes me mjediset e atyshme.

Në rregull. Znj. Sekretare, ju lutem na ktheni në seancë private dhe pastaj do bëjmë prapë mbylljen e seancën në seancë publike.

[Seancë private][Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F793*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Kam një pyetje për Avokatin e Mbrojtjes, së cilës mund t'i përgjigjeni nesër në mëngjes. Por pyetja e Trupit Gjykues është kjo në rast se dëshmitari ka refuzuar, pra, në rastin kur dëshmitari refuzon pranimin e fletëthirrjes, kjo e ndryshon qëndrimin e Mbrojtjes për ta thirrur këtë dëshmitar? Se kemi shumë mundësi, kemi disa mundësi më saktë sesi mund të veprojmë. Por na duhet që të vendosim në drejtpeshim, të kuptojmë, të marrim një vendim.

Po për ne është e rëndësishme se ku qëndron Mbrojtja sa i takon thirrjes ë këtij dëshmitari, duke pasur parasysh edhe rëndësinë e dëshmitarit dhe ndonjë interes tjetër që mund të mbani parasysh. Për të marrë një vendim për të vijuar me këtë procedurë apo.

Nesër në mëngjes do t'ju luteshim që të na jepnit përgjigje për këtë. Faleminderit.

Në rregull. Kthehemi prapë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Prokuroria dëshiron të ngrejë ndonjë gjë?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtja?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, faleminderit shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë ju falënderoj për pjesëmarrjen. Do të rifillojmë nesër në orën 9.30.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

Këtu ndërpritet seanca.

--- Seanca mbyllet në orën 15.56.